



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2026



Komuna e Kaçanikut

PROCESVERBAL

Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026

Data: 28.04.2026

Të pranishëm:

- Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës
- Xhelal Dema, Nënkyetar i Komunës
- Arian Teneqja, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
- Vahid Hyseni, Stacioni Policor – Kaçanik
- Fatmir Tahiri, FSK
- Fatmir Qaka, EVSB
- Elmihane Malsiu, HANDIKOS
- Gazmend Bunjaku, Drejtor i Arsimit
- Naim Hysa, Kryqi i Kuq Komunal
- Ylber Tusha, Përfaqësues i bizneseve
- Diana Muhaxheri, Përfaqësuese e komunitetit
- Shqiponje Vogliqi Rexhepi, KLSP
- Emrin Dema, Këshilli i Prindërve
- Vedat Dema, Zyra për Barazi Gjinore
- Fidaim Fazliu, KBI
- Betim Shala, Komiteti për komunitete

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti mbi gjendjen e sigurisë në periudhën ndërmjet dy takimeve;
3. Masat kundër dhunës dhe bullizmit, mekanizmat për raportim anonim, trajnimet për mësimdhënës dhe vetëdijesimi për rreziqet online;
4. Të ndryshme.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht nga të pranishmit.

Pika 2

Lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Kaçanikut për periudhën ndërmjet dy takimeve, Kryetari fjalën ia dha toger Vahid Hysenit, i cili situatën e sigurisë gjatë kësaj periudhe e cilësoi të qetë, me përjashtim të disa rasteve që nuk kanë cenuar sigurinë qytetare.

Sipas tij, rastet kanë qenë të natyrës së zakonshme dhe janë menaxhuar me sukses. Ndër rastet e evidentuara përmendi dhunën në familje, kanosjet dhe përdorimin e narkotikëve.

Ai potencoi gjithashtu një rast revolte në stacionin policor nga disa qytetarë, i cili sipas tij është menaxhuar me profesionalizëm nga Policia.

Togeri njoftoi se Policia ka dy plane operative: një për sigurinë në shkolla dhe tjetrin për parandalimin e dukurisë së narkotikëve. Për këtë qëllim janë angazhuar zyrtarë shtesë policorë për luftimin e përdorimit dhe shpërndarjes së substancave narkotike.

Ai shtoi se kjo dukuri është shqetësuese në nivel vendi, pasi ndërlidhet edhe me vepra të tjera si dhuna në familje, vjedhjet dhe huliganizmi.

Diskutimet

Kryetari i Komunës theksoi se një kërkesë e kahmotshme ka qenë funksionalizimi i kamerave të sigurisë dhe informoi se tashmë ka filluar instalimi i tyre, me shpresën se do të ndihmojnë në zbardhjen e rasteve.

Ai shprehu gjithashtu vërejtje ndaj Policisë së Kosovës për mungesën e pjesëmarrjes aktive në aktivitetin e 22 Prillit – Ditës Ndërkombëtare të Tokës, me moton “Të gjithë për një ambient të pastër”.

Kryetari përmendi edhe një aksident të vogël në fshatin Kaçanik i Vjetër, i cili fatmirësisht ka kaluar pa pasoja të mëdha.

Lejla Koxha pyeti sa të lirë ndihen qytetarët për të raportuar abuzimet dhe çfarë masash po ndërmerren për të miturit, duke marrë parasysh mbrojtjen ligjore që ata gëzojnë.

Vahid Hyseni u përgjigj se më herët qytetarët kanë hezituuar të raportojnë rastet, por kohëve të fundit bashkëpunimi është përmirësuar. Sa i përket të miturve, ai sqaroi se Policia nuk ka mekanizma të veçantë trajtimi, por rastet përcillen tek organet kompetente të drejtësisë.

Fadaim Fazliu shprehu shqetësimin për seriozitetin e trajtimit të rasteve të raportuara, veçanërisht për dëmtimet e objekteve fetare. Ai tha se disa raste, sipas tij, nuk janë trajtuar si duhet dhe nuk janë marrë masa ndaj personave përgjegjës.

Ai ngriti shqetësim edhe për një rast të paraqitur në gjykatë ndaj një punonjësi të arsimit, për të cilin tha se ende nuk ka marrë përgjigje nga organet e drejtësisë. Sipas tij, personi në fjalë ka fyer personalitetin e tij dhe ka bërë propagandë kundër fesë islame.

Ai kërkoi nga Drejtoria e Arsimit dhe Policia e Kosovës që të ndërmarrin masa disiplinore dhe juridike ndaj personit në fjalë.

Gazmend Bunjaku deklaroi se Drejtoria e Arsimit ka pranuar ankesa lidhur me personin në fjalë dhe ato janë shqyrtuar, mirëpo rastet nuk kanë ndodhur brenda institucioneve shkollore, prandaj trajtimi i tyre bie në kompetencë të Policisë dhe organeve të drejtësisë.

Emrin Dema, si përfaqësues i Këshillit të Prindërve, deklaroi se gjatë tre muajve të fundit nuk ka pasur ankesa nga nxënësit apo prindërit lidhur me rastin në fjalë. Megjithatë, ai u pajtua se personat publikë që punojnë në institucione arsimore duhet të mbajnë përgjegjësi për sjelljet e tyre edhe jashtë institucionit.

Ai falënderoi Policinë e Kosovës për trajtimin e disa ankesave të qytetarëve ndaj zyrtarëve policorë, duke theksuar se situata ka ndryshuar për mirë.

Nga ana tjetër, ai tha se prezenca e zyrtarëve policorë me armë të gjata krijon shqetësim tek qytetarët.

Vahid Hasani sqaroi se të gjitha ankesat trajtohen në mënyrë profesionale dhe sipas procedurave ligjore. Ai shpjegoi rrjedhën institucionale të trajtimit të ankesave dhe shtoi se prezenca e policëve me armë të gjata lidhet me plane operative dhe situatën e përgjithshme të sigurisë.

Ai njoftoi se Policia ka trajtuar edhe rastet e vjedhjeve në objektet fetare dhe se njëri rast është zbuluar, ndërsa për rastin tjetër personi i dyshuar është shpallur në kërkim.

Lidhur me punonjësin arsimor të përmendur, ai tha se Policia ka kryer veprimet në kompetencë të saj dhe rasti është përcjellë në organet e drejtësisë.

Diana Muhagjeri, banore e ndërtesës P8, ngriti shqetësimin për bllokimin e trotuareve nga automjetet dhe mungesën e reagimit nga Policia.

Vahid Hasani u përgjigj se qytetarët duhet të raportojnë rastet në numrin 192 dhe premtoi se rasti do të trajtohet nga stacioni policor.

Kryetari i Komunës tha se Komuna ka tentuar të gjejë zgjidhje për këtë problematikë duke vendosur pengesa metalike, por ato janë dëmtuar. Ai njoftoi se është duke u shqyrtuar mundësia e vendosjes së rampës hyrëse dhe pajisjes së banorëve me kartela digjitale.

Gjithashtu, ai tha se Komuna planifikon gjelbërimin e një pjese të hapësirës.

Lidhur me rastin e mësimdhënësit të përmendur më herët, Kryetari tha se janë bërë përpjekje për përmirësimin e sjelljeve të tij, por në rast të përsëritjes së tyre, masat do të jenë më të rrepta.

Pika 3

Kryetari theksoi se tema e dhunës dhe bullizmit kërkon trajtim serioz dhe gjithëpërfshirës, duke ftuar psikologët e shkollave për të kontribuar në diskutim.

Gazmend Bunjaku tha se siguria në shkolla kërkon koordinim ndërinstytucional dhe bashkëpunim me prindërit dhe shoqërinë. Ai potencoi nevojën për trajnime të stafit arsimor për trajtimin e bullizmit, dhunës dhe dukurive të tjera negative.

Sipas tij, gjendja në Komunën e Kaçanikut nuk është alarmante, falë bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, por kërkohet angazhim më i madh sidomos nga prindërit.

Mirlinda Axhami Hysa deklaroi se rastet e bullizmit ekzistojnë në shkolla, por shumë prej tyre nuk raportohen për shkak të mungesës së mekanizmave adekuatë të raportimit.

Ajo theksoi se bullizmi online është në rritje dhe sjell pasoja të mëdha, duke propozuar krijimin e një ekipi ndërinstytucional dhe hartimin e një plani veprimi për luftimin e kësaj dukurie.

Ajo kërkoi gjithashtu plotësim-ndryshimin e Rregullores së vitit 2019 për shkolla, me qëllim përfshirjen e masave ndaj bullizmit online.

Po ashtu, propozoi krijimin e një sistemi anonim raportimi dhe kërkimin e raporteve periodike nga shkollat për dukuritë negative.

Kryetari tha se krahas diskutimeve duhet të ofrohen edhe alternativa konkrete për zgjidhje. Ai informoi se është diskutuar me Drejtorinë e Arsimit për kufizimin e përdorimit të telefonave në shkolla, plan që pritet të fillojë së zbatuari nga shtatori.

Ai vlerësoi si shqetësues mosfunksionimin e trekëndëshit mësimdhënës – prind – nxënës.

Emrin Dema tha se trajnimet për bullizmin verbal dhe social mund të mbahen nga psikologët, ndërsa për bullizmin online duhet të angazhohen ekspertë të fushës.

Ai theksoi se grupet në rrjetet sociale po ndikojnë në rritjen e bullizmit dhe dukurive të tjera negative.

Lejla Koxha deklaroi se bullizmi online prek të gjitha nivelet shkollore dhe se, falë bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, disa dukuri negative si huliganizmi janë reduktuar ndjeshëm.

Ajo vlerësoi të nevojshëm krijimin e mekanizmave ndërinstytucionalë dhe sistemeve online për raportim.

Zarije Lika ngriti shqetësimin për bullizmin dhe braktisjen e shkollës, duke njoftuar se gjatë këtij viti janë evidentuar katër raste të braktisjes së shkollës.

Vahid Hasani theksoi se shkollimi fillor është obligativ dhe se rastet e braktisjes duhet fillimisht të trajtohen nga institucionet sociale dhe më pas, sipas nevojës, nga organet e drejtësisë.

Pika 4

Fatmir Qaka potencoi se sipas planit të punës së KKSB-së për vitin 2026, në takimet për trajtimin e dukurive negative duhet të marrin pjesë edhe psikologët e shkollave.

Ai përmendi gjithashtu kërkesën e Kuvendit Komunal që në planin e punës të përfshihet edhe tema e qenve endacakë.

Kryetari tha se kjo dukuri është shqetësuese në nivel vendi dhe se mund të trajtohet në kuadër të takimeve të KKSB-së.

Elmihane Malsiu ngriti pyetjen lidhur me pajisjet dhe gatishmërinë e zjarrfikësve në rast emergjencash.


Kryetari u përgjigj se ekipi i zjarrfikësve tashmë është sistemuar në Kovaqec dhe ka kushte më të mira për intervenime.

REKOMANDIMET

1. Të intensifikohet bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet Komunës, Policisë së Kosovës, Drejtorisë së Arsimit, shkollave, prindërve dhe institucioneve sociale në trajtimin e dukurive negative në shkolla dhe komunitet.
2. Të funksionalizohen sa më shpejt kamerat e sigurisë në territorin e Komunës me qëllim të rritjes së sigurisë dhe ndihmës në zbardhjen e rasteve.
3. Të vazhdohet implementimi i planeve operative të Policisë së Kosovës për sigurinë në shkolla dhe luftimin e përdorimit dhe shpërndarjes së narkotikëve.
4. Të organizohen fushata vetëdijesuese dhe aktivitete informuese për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit lidhur me bullizmin, dhunën dhe rreziqet online.
5. Të krijohet një mekanizëm funksional për raportim anonim të rasteve të bullizmit, dhunës dhe dukurive tjera negative në shkolla.
6. Të formohet një ekip ndërinstytucional për hartimin e një plani veprimi kundër bullizmit dhe dukurive negative në institucionet arsimore.
7. Të shqyrtohet mundësia për plotësim-ndryshimin e Rregullores së vitit 2019 për shkolla, duke përfshirë masa konkrete për trajtimin e bullizmit online.
8. Të organizohen trajnime të vazhdueshme për stafin arsimor në fushën e menaxhimit të klasës, edukimit të fëmijëve, komunikimit me nxënësit dhe trajtimin e dukurive negative.
9. Të rritet bashkëpunimi i prindërve me shkollat dhe institucionet relevante për parandalimin e dhunës, bullizmit dhe braktisjes së shkollës.
10. Të vazhdojë prezenca e zyrtarëve policorë dhe ekipeve civile pranë institucioneve shkollore me qëllim të parandalimit të dukurive negative.
11. Të trajtohen me prioritet rastet e dëmtimit të objekteve fetare dhe të rritet bashkëpunimi me komunitetin në raportimin e rasteve.
12. Të ndërmerren masa konkrete për menaxhimin e problemit të parkimit dhe bllokimit të trotuareve në zonat e banuara.

Procesmbajtws:

Fatmir Qaka



Kryesoi:Kryetari

z.Sabedin Vishi



Lista e pjesëmarrësve në mbledhjen e KKSBB-së më datë 09.06.2026

Nga kjo listë për pagesë janë: 1. Elmihane Krasniqi, 2. Shqiponje Vogliqi-Rexhepi, 3. Fidaim Fazliu, 4. Emrin Dema, 5. Naim Hysa, 6. Deana Muhaxheri dhe 7. Ylber Tusha

Vërejtje: pagesën e arsyeton vetëm pjesëmarrja në mbledhje, që dëshmon duke nënshkruar prezencën

Emri e Mbiemri	Institucioni (Organizata)	Nr. i Tel.	E-mail	Nënshkrimi
Fatmir Qeka	EUSB	044-346-157	fatmirqeka@gmail.com	
Elmi Hame Malsiu	Hamolikos	044 235 717	brandikoskaga@gmail.com	
EMRIN DEMA	KESHILLI PRINDËRË	044-490-924	emrindema@gmail.com	
Shqiponje Vogliqi	KLSP	045618065	beni.vogliqi@gmail.com	
Diana Muhaxheri	P.M	049323045	diamatmuhaxheri@gmail.com	
YLBER TUSHA	P. Bismosore	044-227825	ylber.tushi@gmail.com	
NAIM HUSA	KRYRI I KUÇ	044-224881	kozani.kuc@redcross-ks.org	
VEDAT DEMA	ZK 69	044279316	vedat.dema@gmail.com	
DFI ALDI BLYTA	FSK	045-982-725 043778810	gc.admim@fsk-ks.org	
Fidaim Fazliu	Kb1	044/887-455	fidaim.fazliu@gmail.com	
VAHID HYSENI	vekeci	044/191/980	vahidhyseni@vekeci.org	
Xhelal Dema	Nensiyetori Komunes	044 310 424	xhelal.dema@gmail.com	
IRBEN FERA	KOMUNA KAGANIK DSHPE	044/260-175	irben.fera@rks-pa.net	
Fatime Guri Selimi	Informin			

Vërtetoi: Kryetari i Komunës

z. Sabedin Vishi

